




JOINT SDG FUND



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SËNDETËSISE
DHE MBROJTJES SOCIALE



UNITED NATIONS
ALBANIA



unicef 
for every child

Kujdesi shoqëror në bashki – mjedisi institucional, kapacitetet, problematika



Ky studim ndihmon për arritjen e OZhQ Nr.



Ky raport është hartuar nga HDPC-ja me mbështetjen e UNICEF-it në kuadrin e projektit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri "Për financimin e OZhQ-ve" mbështetur nga JSDGF. Raporti është përgatitur për botim në qershor të vitit 2022, pas një pune intensive gjatë periudhës shtator 2021 - mars 2022.

Autorë: Linda Rama, Elena Polo


HDPC-ja falënderon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimin Social Shtetëror për mbështetjen dhe kontributin në hartimin e pyetësorit dhe 61 bashkitë për plotësimin në kohë dhe me cilësi të informacionit të kërkuar.

Një falënderim i veçantë i drejtohet znj. Alketa Zazo nga UNICEFi, znj. Denada Seferi dhe znj. Merita Xhafaj nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe znj. Etleva Bisha e znj. Mirela Arqimandriti për kontributin e tyre në procesin hartues të pyetësorit, si dhe në procesin e diskutimit të rezultateve.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk reflektojnë mendimin e UNICEF-it.



JOINT SDG FUND



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



UNITED NATIONS
ALBANIA



unicef 
for every child



HUMAN DEVELOPMENT PROMOTION CENTER

PERMBAJTJA

Hyrje	4
Gjetjet kryesore	7
I. Strukturat, burimet njerëzore dhe problematikat e lidhura me to	7
I.1 Strukturat vendore të mbrojtjes sociale - informacion i përgjithshëm.....	7
I.2 Strukturat e mbrojtjes sociale - problematikat	8
I.3 Burimet njerëzore dhe kapacitetet.....	15
I.4 Përshtatshmëria e mjediseve të punës	20
II.Koordinimi, komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional	21
III. Shërbimet e kujdesit shoqëror dhe financimi i tyre	27
IV. Përfundime	36
IV.1 Burimet njerëzore dhe kapacitetet	37
IV.2 Përshtatshmëria e mjediseve të punës.....	37
IV.3 Koordinimi, komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional	37
IV.4 Shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki	38
IV.5 Financimi i shërbimeve sociale	39
Shtojcë: Pyetësor – vlerësimi i kapaciteteve/problematikës të organeve të qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve sociale	40

Hyrje

Strategjia ndërsektoriale, "Për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, 2015-2020", i parapriu vendimit për decentralizimin e funksionit të ofrimit të shërbimeve sociale vendore dhe kalimin e tij në kompetencë të bashkive, të cilat nga ana e tyre u ngarkuan të krijonin zyrat e shërbimeve sociale të integruara për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e individëve dhe familjeve në nevojë përmes programeve të ndihmës ekonomike dhe të kujdesit social. Po kështu, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, 2015-2020, nënvizoi nevojën për rritjen e ofertës së shërbimeve sociale në të gjithë territorin, si një domosdoshmëri për të mbështetur jo vetëm kërkesat për shërbime të individëve, por dhe skemat e reformuara të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Në zbatim të këtij vizioni strategjik, u miratua Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ngarkoi njësitë e pushtetit vendor me një gamë të gjerë përgjegjësish dhe funksionesh të reja, përfshirë ato në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror që lidhen me identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e masave për plotësimin e nevojave të komunitetit, në përgjithësi dhe grupeve në nevojë, në veçanti, si dhe Ligji nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", i cili përcaktoi rolin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (neni 31) si përgjegjëse për përcaktimin e politikave, standardeve minimale të shërbimeve, kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, këshillimin dhe udhëzimin e bashkive për planifikimin e shërbimeve dhe strukturat përgjegjëse, si dhe planifikimin e nevojave për financim të shërbimeve nga buxheti i shtetit. Ky ligj përcaktoi funksionet e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, funksionet e Njësisë të Vlerësimit të Nevojave dhe të Referimit (NjVNR) në secilën njësi administrative me më shumë se 6 000 banorë, si dhe standardin sipas të cilit NjVNR-ja duhet të ketë të paktën një punonjës social për vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve për çdo 6 000-10 000 banorë, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës për çdo 3 000 fëmijë dhe një administrator social.

Raporti i vlerësimit të ecurisë së zbatimit të strategjisë për mbrojtjen sociale në vitin 2019 konstatoi se bashkitë përballen me sfida sa i takon ofrimit të shërbimeve për të gjitha grupet në nevojë, shpërndarjes së shërbimeve shoqërore dhe mbulimit territorial që ato garantojnë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, burimeve financiare në dispozicion dhe prokurimit të tyre, si dhe mungesës së strukturave dhe të kapaciteteve vendore për vlerësimin e nevojave, planifikimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale.

Nga komunikimi dhe bashkëpunimi me bashkitë, konstatohet që, vitet e fundit, ka pasur zhvillime pozitive në drejtim të reformimit të sistemit ekzistues të shërbimeve me theks tek pushteti lokal, të rritjes së ofertës së shërbimeve në komunitete, jo vetëm për t'u ardhur në ndihmë individëve në nevojë, por edhe për të krijuar kushtet për një perspektivë ekonomike nëpërmjet punësimit për familjet e mbështetura nga programi i ndihmës ekonomike dhe i aftësisë së kufizuar, të rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional midis pushtetit qendror dhe vendor dhe krijimit të modeleve të mira të shërbimeve sociale.

Të gjitha bashkitë kanë miratuar planet e tyre sociale vendore. Në vitin 2019, u aktivizua fondi social qendror për financimin e ngritjes së shërbimeve të reja sociale apo konsolidimin e atyre ekzistuese si pjesë e fondit social vendor, ndërkohë që vijon reforma e deinstitutionalizimit të shërbimeve. Në këtë rrugëtim, ka pasur një rëndësi të posaçme mbështetja nga Programi i OKB-së, "Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve lokale të mbrojtjes sociale", i financuar nga Fondi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe i zbatuar nga qeveria shqiptare, në bashkëpunim me katër agjencitë e OKB-së, PNUD-i, UNICEF-i, UN Women dhe OBSH-ja, me pjesëmarrjen e UNFPA-së dhe ILO-s, si dhe mbështetja nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara, "Leave No One Behind" (Askush të mos mbetet pas).

Zbatimi i agjendës transformuese të shërbimeve shoqërore kërkon domosdoshmërisht struktura institucionale funksionale në të gjitha nivelet, me burime njerëzore jo vetëm të mjaftueshme për t'iu përgjigjur detyrimeve ligjore të tyre, por edhe të mirëtrajnuara, për të përballuar të gjitha sfidat me të cilat ndeshen. Aktualisht, drejtuesit dhe personeli i bashkive janë më të qartë për rëndësinë e shërbimeve sociale për t'iu përgjigjur nevojave të komuniteteve, situatës dhe vështirësive me të cilat ballafaqohen në ngritjen apo funksionimin e shërbimeve, përfshi ato financiare, si dhe në angazhimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe të kapaciteteve të duhura të të gjitha strukturave përgjegjëse. Për të kuptuar më mirë mundësitë që ekzistojnë për zbatimin e Ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", në periudhën tetor-dhjetor 2021, u krye një fotografim i situatës ekzistuese në 61 bashki lidhur me: (i) strukturat ekzistuese dhe burimet njerëzore në dispozicion, për të zbatuar funksionet e deleguara me ligj lidhur me Ndihmën Ekonomike, Aftësinë e Kufizuar dhe Shërbimet Shoqërore për individët në nevojë; (ii) situatën e burimeve njerëzore të NjVNR-ve, problematikën ekzistuese, situatën e shërbimeve sociale etj.

Metodologjia

Për kryerjen e këtij fotografimi u përdorën këto hapa metodologjike: (i) Njohje e thelluar e kuadrit ligjor që rregullon aktivitetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror, Njësive të Qeverisjes Vendore dhe kuadrit bashkëpunimin e tyre me aktorë të tjerë në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale, si dhe të kuadrit ligjor që lidhet me shportën e shërbimeve; (ii) diskutime paraprake në të gjitha nivelet mbi aspektet më të rëndësishme të funksionimit të njësive vendore, që përcaktojnë sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve sociale në komunitetet e tyre; (iii) hartimi i pyetësorit, “Vlerësim i kapaciteteve të pushtetit vendor për të përballuar funksionet e deleguara lidhur me ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve sociale”, me tri rubrika kryesore, përkatësisht, “Informacion i Përgjithshëm”, “Informacion mbi organizimin, funksionimin dhe kapacitetet e strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale” dhe “Informacion për shportën e shërbimeve dhe financimin e tyre përfshirë dhe fondin social”, pilotimi i pyetësorit në një bashki të madhe, një bashki të mesme dhe një bashki të vogël dhe, pas përmirësimeve dhe saktësimeve, plotësimi i pyetësorit nga 61 bashkitë; (iv) diskutime me Shërbimin Social Shtetëror, Inspektoratin e Lartë të Punës dhe Shërbimeve, bashkitë, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, përfaqësues të Bashkëpunimit zviceran dhe të Delegacionit të Komisionit European në Shqipëri lidhur me rezultatet e anketës dhe vleftësimi i gjetjeve kryesore.

I. Gjetjet kryesore

I.1 Strukturat, burimet njerëzore dhe problematika të lidhura me to

Strukturat vendore të mbrojtjes sociale - informacion i përgjithshëm

Bashkitë janë shprehur lidhur me drejtoritë/sectorët/zyrat që janë të ngarkuara me funksionin e zbatimit të Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", pozicionet e punës, gjininë, arsimimin dhe eksperiencën në punë, si dhe eksperiencën në fushën e mbrojtjes sociale të personelit të punësuar. Nga sa më sipër, rezulton se:

- Shërbimet shoqërore janë funksion i drejtorive, sektorëve/zyrave të larmishme nga pikëpamja e emërtimeve që kanë dhe funksioneve që kryejnë. Funksionet e mbrojtjes shoqërore në bashki janë strehuar në struktura të ndryshme, të quajtura kryesisht Drejtoria/ Sektori i "Shërbimeve Sociale", Sektori i Buxhetit dhe Ndihmës Ekonomike, Zyra/sectori i Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe, Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Ndihmës Ekonomike dhe Strehimit, Sektori i Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimit Social, Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit dhe Menaxhimit Financiar", Agjencia e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Kulturës etj. Përgjithësisht, bashkitë qendër qarku kanë në strukturën e tyre organizative drejtori të shërbimeve sociale, ndërsa në rastin e bashkive të tjera nuk ekzistojnë ende drejtori me identitet të qartë që lidhet me mbrojtjen sociale, por modifikime të sektorëve tradicionalë që përfshijnë edhe funksionet e mbrojtjes sociale. Nëse u referohemi pozicioneve të punës brenda strukturave të ngarkuara me mbrojtjen sociale, ato janë më së shumti të lidhura me administratorin social të ngarkuar me ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar.

- Në të gjitha bashkitë, në strukturat që lidhen me mbrojtjen sociale shumica mbizotëruese e të punësuarve janë gra, ndërsa fusha e arsimit të punonjësve është edhe më e shumëllojshme se emërtimet e drejtorive dhe sektorëve ku punojnë, mes të cilave spikatin mësuesia, gjuhë-letërsia, inxhinieria, drejtësia, ekonomia, shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare, shkencat e natyrës, turizmi, gjuha e huaj, cikli i ulët, gjeografia etj. Ekziston një zhvillim pozitiv në disa bashki (Lezha, Tirana, Durrësi), të cilat kanë arritur të përputhin në një masë të madhe pozicionet e punës me profilin arsimor dhe me eksperiencën në fushën e shërbimeve sociale. Në rastet kur kjo përputhshmëri nuk ekziston, eksperiencia e punës në fushën e mbrojtjes sociale është një element i rëndësishëm për cilësinë e kryerjes së funksionit.


- Pozicioni i punonjësit të ngarkuar për mbrojtjen e fëmijës dhe për viktimat e dhunës dhe barazinë gjinore rezulton në pjesën më të madhe të bashkive si një pozicion i dedikuar, por ka ende shumë raste kur këto funksione përmbushen nga punonjës që kryejnë edhe funksione të tjera, duke mos u shfaqur si terminologji në emërtimin e pozicioneve. Arsyet janë të ndryshme, por ato më ndikuese janë madhësia e bashkisë, numri dhe madhësia e njësisë administrative, mundësia e bashkive për të plotësuar nevojat me personel në këto funksione.

• Bashkitë kanë një shkallë të ulët të lëvizshmërisë së personelit që kryen funksionet e mbrojtjes sociale. Një pjesë e konsiderueshme e personelit e ka pothuaj të gjithë eksperiencën e punës në këtë fushën. Mungesa e përputhshmërisë së profilit arsimor me shërbimet sociale motivon nevojën për investim në trajnime, ndërsa lëvizshmëria e ulët e personelit garanton se investimet në trajnime do të jenë të dobishme për strukturat lokale dhe komunitetin.

1.2 Strukturat e mbrojtjes sociale - problematikat

Bashkitë janë shprehur lidhur me strukturat përgjegjëse për mbrojtjen sociale. Përqindja e bashkive që kanë strukturë të dedikuar apo, ekstremi tjetër, që nuk kanë asnjë mbulim me personel, për secilin funksion të parashikuar në ligj është paraqitur në grafikun në vijim. Nuk ka asnjë funksion që rezulton i mbuluar me strukturë të dedikuar në të gjitha bashkitë. Funksionet që kryhen nga struktura të dedikuara në pjesën më të madhe të bashkive janë “mbrojtja dhe përkujdesi i fëmijëve” (64%), “administrimi i pagesave me para në dorë të ndihmës ekonomike” (41%) dhe “mbrojtja kundër dhunës gjinore në familje” (41%). Funksionet që mbulohen pothuaj në të gjitha bashkitë janë mbrojtja e fëmijës, administrimi i ndihmës ekonomike dhe barazia gjinore, ndërsa funksionet e pambuluara nga një numër i madh i bashkive janë “prokurimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror” (50%), “ngritja e shërbimeve të kujdesit shoqëror” (më shumë se 40% e bashkive) dhe “planifikimi strategjik i shërbimeve të kujdesit shoqëror” (më shumë se 30% e bashkive).


Funksionet dhe lloji i strukturës



Duke iu referuar situatës në njësitë administrative në varësi të bashkive, rezulton se 147 nga 399 njësi administrative (37%) nuk kanë Njësi për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NjVNR) dhe iu mungon personeli për të kryer funksionet e NjVNR-së. Në njësitë administrative ku ekziston NjVNR-ja, janë të angazhuar 498 punonjës, të cilët kryejnë më së shumti disa funksione njëherësh. Kështu, bashkitë pohojnë se ka 450 punonjës, të cilët kryejnë funksionin e administratorit shoqëror (NE dhe PAK), 213 punonjës kryejnë funksionin e punonjësit social, 140 punonjës kryejnë funksionin për mbrojtjen e fëmijës dhe 102 punonjës trajtojnë dhunën në familje. Pra, 75% e punonjësve në NjVNR kryejnë më shumë sesa një funksion dhe i shërbejnë më shumë sesa një kategorie në nevojë. Bashkitë pohojnë se 22% e njësive administrative nuk kanë administratorë shoqërorë, 57% kanë një administrator shoqëror dhe vetëm 6% e njësive administrative kanë më shumë se 3 administratorë shoqërorë¹. Funksionet e pambuluara me personel rezultojnë dhuna në familje (75% e njësive nuk kanë asnjë punonjës të posaçëm për dhunën në familje), ndjekur nga mbrojtja e fëmijës (68% e njësive nuk kanë punonjës të dedikuar për këtë funksion) dhe 63% nuk kanë asnjë punonjës social.

Vlen të theksohet se NjVNR-ja konsiderohet e ngritur nëse ka në përbërjen e saj punonjës social, punonjës për mbrojtjen e fëmijës dhe administratorin social, të cilët i ushtrojnë kompetencat e tyre në bazë të përshkrimeve të punës që burojnë nga rolet e përgjegjësive të përshkruara në ligj. Mbi bazën e këtij përkufizimi dhe referuar deklarimeve të mësipërme, në realitet, mund të ketë më shumë njësi administrative pa NjVNR sesa 37% të deklaruarat.


NjVNR-ja në nivel njësie



- Njësitë administrative që kanë NjVNR operative
- Njësitë administrative ku nuk është ngritur ende NjVRN ose nuk ka asnjë personel


¹ Në ligjet për shërbimet dhe ndihmën sociale nuk ka detyrim mbi numrin e administratorëve socialë në nivelin e njësive administrative.

Punonjësitë për mbrojtjen sociale në njësitë administrative



Sa më sipër, 55% e bashkive deklarojnë se NjVNR-ja nuk ka buxhet për menaxhimin e rasteve, 27% deklarojnë se NjVNR-të kanë buxhet për menaxhimin e rasteve dhe 18% shprehen se nuk kanë informacion lidhur me këtë.


Njësia/ Sektori/Detyra




- Numri i përgjithshëm i punonjësve të NjVNR
- Numri i punonjësve social
- Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijës
- Numri i koordinatorëve të dhunës në familje
- Administratori shoqëror (NE dhe PAK)
- Sa punonjës të NjVNR kryejnë më shumë se një prej funksioneve më sipër

Bashkitë janë pyetur mbi disa aspekte që lidhen me rolin që kryejnë NjVNR-të, sipas rregullores së institucionit. Grafikët e mëposhtëm paraqesin një panoramë të këtyre aspekteve, si detyrat që kryejnë, numrin e njësive të angazhuara në kryerjen e detyrës, numrin gjithsej të punonjësve dhe nëse funksioni përmbushet nga bashkia, në rastet kur nuk e kryen NjVNR-ja. Ka ende bashki të cilat nuk kryejnë detyra të cilat ua ngarkon ligji. Detyrat që nuk mbulohen më së shumti janë hedhja e të dhënave në regjistrin kombëtar elektronik dhe menaxhimi i rasteve të pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike për t'i fuqizuar ekonomikisht. Detyrat që mbulohen më së shumti nga një strukturë e dedikuar janë menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (52%), aplikimi për përfitimin e ndihmës ekonomike (48%) dhe menaxhimi i rasteve të viktimave të dhunës në familje (42%).

Detyrat dhe lloji i strukturës




Lidhur me detyrat:




Të gjitha funksionet që nuk kryhen nga Njvnr-të mbulohe plotësisht apo pjesërisht nga ana e bashkive dhe kjo qasje është një realitet për shumicën e tyre. Ky aktivitet i shtuar për punonjësit e bashkive mund të shoqërohet me mungesë efikasiteti nga ana e tyre në kryerjen e funksioneve që lidhen me mbrojtjen sociale në nivel bashkie.

Kryerja e funksionit nga bashkia në rastin kur nuk e kryen njësia administrative




Bashkitë janë pyetur për vështirësitë që hasin NjVNR-të në përmbushjen e rolit të tyre. Ato shprehen se mungesa e financimeve të aktivitetit të tyre është vështirësia kryesore e NjVNR-ve në zbatimin e funksioneve (78% e bashkive), ndjekur nga kapacitetet e ulëta të personelit në NjVNR-së (41% e bashkive) dhe mungesa e shërbimeve specifike në NjVNR (41% e bashkive), që pengojnë trajtimin e rastit nga ana e tyre.

Vështirësitë e personelit të NjVNR-së në përmbushjen e detyrave funksionale



Ndërkohë, 55% e bashkive deklarojnë se NjVNR-të nuk kanë buxhet të parashikuar për menaxhimin e rasteve sociale dhe vetëm 27% e bashkive deklarojnë se njësitë kanë buxhet. Janë 11 bashki që nuk kanë dijeni lidhur me ekzistencën e buxheteve për njësitë vendore.

NjVNR ka buxhet të parashikuar për menaxhimin e rasteve sociale



Po


Jo

Nuk e di

I.3 Burimet njerëzore dhe kapacitetet


Ndihma ekonomike, ndihma për personat me aftësi të kufizuar, dhuna në familje dhe mbrojtja e fëmijës janë funksionet më të madh me personel. Funksionet më pak të mbuluara janë planifikimi strategjik, ngritja e shërbimeve dhe monitorimi, prokurimi i shërbimeve publike etj. Bashkitë janë të ndërgjegjësuar për numrin e pamjaftueshëm të personelit që kanë strukturat e shërbimit social për të përmbushur funksionet ligjore. Mes tyre, 80% e bashkive shprehen se personeli aktual nuk është i mjaftueshëm, 25% deklarojnë se u duhen 1-2 punonjës më shumë, 10 bashki (16%) kanë nevojë për 3 punonjës shtesë dhe pjesës tjetër (40%) u duhen 4 ose më shumë punonjës shtesë të personelit. Në aspektin gjinor, numri i grave dhe vajzave punonjëse në strukturat e shërbimeve në bashki e kalon ndjeshëm numrin e burrave.

Nevoja e bashkive për personel shtesë




Ka tri arsye kryesore që shpjegojnë pamjaftueshmërinë e personelit që merret me mbrojtjen sociale në bashki, konkretisht, mungesa e buxhetit (91%), mosndërgjegjësimi i vendimmarrësve vendorë për rëndësinë e shërbimeve sociale (20%), mungesa e aplikimeve në rastin e rekrutimeve të reja (13%).

Arsyet kryesore të pamjaftueshmërisë/mungesës së personelit



Bashkitë janë pyetur nëse ndodh që në praktikën e punës së njësisë përgjegjëse të shërbimit social të bashkisë personeli të përfshihet në menaxhimin e rasteve sociale. 80% e bashkive pohojnë se kjo ndodh dhe vetëm 20% e tyre shprehen se kjo nuk ndodh. Përfshirja e personelit të bashkisë në menaxhimin e rasteve që ligjërisht i takon nga personelit të NjVNR-së është rrjedhojë e mungesës së personelit në njësitë administrative (51%), kapaciteteve të ulëta të personelit në NjVNR (20%), mungesës së shërbimeve specifike në NjVNR për ta trajtuar rastin (41%), mungesës së buxhetit në NjVNR (47%), mungesës së personelit apo mungesës së vetë NjVNR-së (31%). Përfshirja në menaxhimin e rasteve e pengon personelin të kryejë funksionet e tij parësore, duke e ulur kështu efikasitetin e strukturave në bashki. Nga ana tjetër, për strukturat e shërbimit social në bashki, vështirësitë kryesore në përmbushjen e funksioneve të tyre lidhen me mungesën e financimit të aktivitetit (74%), mungesën e kapacitetit të personelit (28%) dhe pamjaftueshmërinë e personelit të angazhuar (61).

Arsyet e përfshirjes së personelit




Bashkitë janë pyetur mbi mjaftueshmërinë e personelit të NjVNR për të plotësuar funksionet e tyre. Vetëm 20% e bashkive e konsiderojnë personelin të mjaftueshëm, 80% ose e konsiderojnë personelin të pamjaftueshëm, ose deklarojnë se NjVNR-të nuk ekzistojnë. Numri mesatar i punonjësve që duhet shtuar në NjVNR-të me personel të pamjaftueshëm është 6,3 dhe numri mesatar që duhet shtuar aty ku nuk ka personel është 6,4. Numri maksimal i deklaruar si i nevojshëm për t'u shtuar është 68 punonjës në njësitë që kanë NjVNR dhe 15 punonjës, në rastin kur NjVNR-ja nuk ekziston.

A është i mjaftueshëm personeli aktual i NjVNR-ve?	Numri i bashkive	%	Numri i personelit shtesë të nevojshëm/bashki			
			Mesatarja	Mediana	Minimumi	Maksimumi
Po	12	20%				
Jo	35	57%	6.3	3	1	68
Nuk ekziston asnjë NJVNR	14	23%	6.4	4	3	15


Arsyeja kryesore e deklaruar e mungesës së personelit të nevojshëm në NjVNR është mungesa e buxhetit (95%), por ka 12 bashki të cilat deklarojnë se autoritetit vendimmarrës i mungon ndërgjegjësimi për rëndësinë e shërbimeve sociale.

Pengesat për arritjen e numrit të nevojshëm të punonjësve në çdo NjVNR




Bashkitë u shprehën edhe lidhur me planin e trajnimit të personelit në bashki dhe në NjVNR. Rezulton se 34 bashki (56%) nuk kanë plan trajnimi, 30% (7 bashki) nga 44% e bashkive që disponojnë një plan trajnimi deklarojnë se kanë plan individual trajnimi, 52% kanë një plan të përgjithshëm trajnimi dhe 58% deklarojnë se plani i trajnimit është i integruar në planin social vendor.

Natyra e planeve të trajnimit




Mbi 90% e bashkive iu përgjigjën pyetjes mbi trajnimet sipas fushave. Sipas rezultateve, 75% e bashkive pohojnë se personeli është trajnuar për planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror tre vitet e fundit, 57% e bashkive deklarojnë se kanë marrë trajnim për procedurat e ngritjes së shërbimeve, 23% e bashkive kanë marrë trajnim për prokurimin e shërbimeve, 31% kanë marrë trajnime në fushën e standardeve kombëtare dhe teknikave të monitorimit të cilësisë së shërbimeve, ndërsa 67% e bashkive kanë marrë trajnim për përfshirjen sociale dhe aksesueshmërinë. Trajnimet vlerësohen të dobishme dhe shumë të dobishme. Më shumë se 97% e bashkive konstatojnë se kanë ende nevojë të marrin trajnime në secilën fushë.

Përshtatshmëria e mjediseve për menaxhimin e rasteve




- Po
- Jo
- Pjesërisht

Parashikimi i fondeve për të siguruar përshtatshmërinë e mjediseve



- Po
- Jo
- Nuk e di

Mbi trajnimet sipas fushave



I.4 Përshtatshmëria e mjediseve të punës

Bashkitë janë shprehur lidhur me përshtatshmërinë e mjediseve të punës për të punuar profesionalisht me menaxhimin e rasteve, veçanërisht me personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe viktimat e dhunës në familje. Vlerësohet se 24% e bashkive kanë mjedise të përshtatshme, 41% e bashkive nuk kanë mjedise të përshtatshme dhe 35% e bashkive deklarojnë se kanë mjedise pjesërisht të përshtatshme. Vetëm 8% e bashkive me mjedise të papërshtatshme shprehen se kanë planifikuar fonde për ndërhyrje në këtë drejtim. Pjesa tjetër pohon se nuk janë planifikuar fonde ose se nuk e kanë këtë informacion.

II. Koordinimi, komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional

Bashkitë u pyetën lidhur me ndërveprimin e strukturës përgjegjëse të bashkisë me NjVNR-në me drejtoritë e tjera në bashki, zyrat vendore të punës, Shërbimin Social Shtetëror dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Bashkëpunimi me NjVNR-në: deklarohet se është më i shpeshtë për identifikimin e grupeve në nevojë për NE (79%), identifikimin e nevojave për shërbime (77%) dhe lidhur me fushatat e informimit për komunitetin (77%).

Bashkëpunimi me drejtoritë në bashki: ekziston një nivel i ulët ndërveprimi midis strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki me drejtoritë e tjera brenda bashkisë. Ndërveprimi më i shpeshtë rezulton të jetë me Drejtorinë e Financës lidhur me pagesat e NE-së dhe PAK-ut, si dhe lidhur me buxhetimin e aktiviteteve dhe të shërbimeve. Ka një nivel të ulët bashkëpunimi me Drejtorinë/Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe me Drejtorinë/Sektorin e Strehimit.


Bashkëpunimi me Zyrat Vendore të Punësimit: lidhet kryesisht me fushatat e informimit (82% e bashkive), menaxhimin e rasteve (72%) dhe për trajnime (36%). Ndërveprimi është konsideruar shumë i mirë nga 64% e bashkive.

Bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror: 70% e bashkive shprehen se ShSSH-ja kontrollon ekzekutimin e pjesës së fondit social, të financuar nga buxheti i qeverisjes qendrore, 64% deklarojnë se komunikojnë me të përgjatë procesit të përgatitjes së planeve sociale dhe 70% shprehen se ndërveprojnë për referimin e rasteve apo trajnimin e personelit të shërbimit social në bashki.


Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: 54% e bashkive shprehen se struktura përgjegjëse e shërbimit social nuk ka komunikim të drejtpërdrejtë në ministrinë. Ndër 46% të bashkive (28 bashki) që deklarojnë se komunikojnë me këtë institucion, 4 prej tyre pohojnë se kanë komunikuar për Fondin Social. Pjesa më e madhe e bashkive shprehen se ministria duhet t'i mbështetë më shumë me buxhet të dedikuar për shërbimet sociale dhe me një vlerë më të madhe, me trajnime për ngritjen e kapaciteteve dhe me financimin e Planit Social e ngritjen e qendrave komunitare.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile: bashkitë shprehen se bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile për fushata informimi dhe komunikimi (82%), trajnime (67%), financimin e shpenzimeve gjatë menaxhimit të rasteve sociale (64%) dhe për menaxhimin e rasteve (74%).


Ndërveprimi i strukturës përgjegjëse në bashki me NJVNR-në në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror




Arsyet e ndërveprimit me Drejtori/sector/njësi të Bashkisë




Natyra e bashkëpunimit me institucione të tjera lokale




Vlerësimi i bashkëpunimit me institucione vendore




Komunikimi me ministrinë




Rastet e komunikimit me MShMS-në



Rastet e ndërveprimit me Shërbimin Social Shtetëror




Rastet e bashkëpunimit me Oshc-të



III. Shërbimet e kujdesit shoqëror dhe financimi i tyre


Bashkitë u pyetën lidhur me vështirësitë që hasin për zbatimin e planeve të tyre sociale sipas afateve dhe cilësisë së parashikuar. Mungesa e financimit (90%) dhe mungesa e burimeve njerëzore (60%) janë vështirësitë më të mëdha për bashkitë.



Procesi i hartimit të planeve sociale ka përkuar me ngritjen e strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në shumë bashki si dhe me krijimin e NjVNR-ve në njësitë administrative. Bashkitë paraqesin një situatë mjaft të larmishme lidhur me njësitë/burimet njerëzore në dispozicion për vlerësimin e nevojave për shërbime dhe, po ashtu, ato disponojnë nivele të ndryshme të ofertës së shërbimeve për t'iu përgjigjur rasteve që duhet të menaxhojnë.

Bashkitë u pyetën edhe rreth nevojave që kanë në të ardhmen për hartimin dhe zbatimin e planeve sociale. Mbështetja financiare për buxhetin (52%), personeli shtesë i kualifikuar dhe me eksperiencë (25%), mbështetja nga ekspertë të fushës dhe me trajnime (18%) janë nevojat më të mëdha që identifikuan ato.


Nevojat e ardhshme të strukturave përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planit Social



Bashkitë u pyetën rreth shërbimeve publike të kujdesit shoqëror që janë aktualisht funksionale në territorin e bashkisë. Nuk ka asnjë shërbim që të jetë i pranishëm në të gjitha bashkitë, ndërsa çdo shërbim i parashikuar nga VKM-ja Nr. 518 ekziston në të paktën një bashki. Informimi dhe këshillimi është shërbimi më i përhapur (44 bashki), i ndjekur nga shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror (28 bashki), shërbimet e emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje" (25 bashki), qendër ditore për të moshuarit (25 bashki). Shërbimet më të pambuluara janë strehëza për të rriturit në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social, shërbime rehabilitimi për personat në varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar, strehëz për të rriturin ose të moshuarin që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten, strehëz për gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç, strehëz për fëmijët në konflikt me ligjin, strehëz për fëmijën dhe/ose të rriturin viktimë të abuzimit apo strehim afatgjatë për personat me aftësi të kufizuar.


Vërehet gjithashtu se shërbimi i këshillimit përmes internetit (online) apo me telefon është i pranishëm vetëm në 23 bashki, ndonëse këto shërbime janë kombëtare.

Bashkitë që kanë shërbimin sipas VKM 518



Duke analizuar burimet e financimit të shërbimeve shoqërore, vërehet se bashkia është financuesja kryesore e shërbimeve, ndjekur nga financimet e OJF-ve. Pesha e financimit të nga qeverisja qendrore është e kufizuar dhe ende në nivele domethënëse në rastin e financimit të strehimit për personat me aftësi të kufizuara, strehimit të të moshuarve apo qendrës për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit.

Mesatarja e peshave të financimit të shërbimit sipas VKM 518




Shënim: Mesatarja e peshave të paraqitura në tabelë nuk merr në konsideratë madhësitë e bashkive dhe vlerën nominale të secilit financim, rrjedhimisht ajo nuk mund të përdoret si tregues për shpërndarjen e përgjithshme të financimeve.

Koment: Kolona e fundit tregon se OJF-të, aty ku vendosin të ndërhjynë, kanë peshë relative të madhe, sidomos të bashkitë e vogla, por, megjëse në shumicën e bashkive ato janë të pranishme vetëm për disa shërbime specifike, pesha e tyre e përgjithshme bie.


Bashkitë janë pyetur mbi burimet e financimit që përdorin për ta bërë Planin Social të zbatueshëm. Prej tyre, 41 bashki deklaruan të ardhurat nga buxheti i shtetit si burim financimi, 33 bashki përdorin të ardhurat e veta, 21 bashki u shprehën se përdorin Fondin Social dhe fonde nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 30 bashki përdorin fonde të organizatave joqeveritare (mbështetje financiare nga donatorët). Zbatimi i tarifave nuk është ende praktikë në ofrimin e shërbimeve ndërkohë që kuadri nënligjor ka nevojë të plotësohet.

Burimet e financimit për ta bërë Planin Social të zbatueshëm




Nga tri vitet e fundit (2019-2021) rezulton se përqindja e të ardhurave të veta të bashkive e përdorur për të financuar aktivitetet e planit social është rritur përkatësisht 4,8% në vitin 2019, 5,8% në vitin 2020 dhe 6,1% në vitin 2021. Megjithatë, në vitin 2021, 65% e bashkive i kanë të ardhurat e veta për të financuar planin social më pak se 2%.

Mesatarja e % të ardhurave të veta të Bashkisë të alokuara për zbatimin e Planit Social



% e të ardhurave të veta të parashikuara për Planin Social



Njëzet e dy bashki pohuan se nuk kishin aplikuar asnjëherë për Fondin Social në ministri, 16 prej tyre për shkak të vështirësive të hasura për hartimin e projektit dhe 6 të tjera nuk ishin informuar për mundësinë e aplikimit.

Bashkitë u pyetën se kush e përgatit aplikimin e bashkisë për Fondin Social dhe 27 prej tyre konfirmuan se është struktura përgjegjëse e shërbimit social ajo që merret me përgatitjen, 17 bashki pohuan se projekti hartohet nga struktura përgjegjëse për shërbimin social në bashkëpunim me njësinë e projekteve të bashkisë, 14 bashki nga bashkëpunimi midis strukturës përgjegjëse për shërbimin social me organizata joqeveritare dhe vetëm 3 bashki kanë marrë konsulencë nga jashtë për këtë qëllim. Sa i takon procesit të përgatitjes së aplikimit për Fondin Social, 64% e bashkive deklaruan se ndeshen me vështirësi që kryesisht lidhen me mungesën e eksperiencës dhe ekspertizës për këtë qëllim. Për të tejkaluar vështirësitë, mënyra më e preferuar për bashkitë duket se është angazhimi i konsulentëve të jashtëm, si dhe marrja e trajnimeve për këtë qëllim, përfshi orientimin nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.


Metodat e përgatitjes së aplikimeve të FS



- Vetëm struktura përgjegjëse e shërbimit social në Bashki
- Struktura përgjegjëse e shërbimit social në Bashki në bashkëpunim me njësinë e projekteve të Bashkisë
- Struktura përgjegjëse e shërbimit social në Bashki në bashkëpunim me një organizatë joqeveritare
- Konsulent jashtë Bashkisë

Bashkitë kanë vështirësi në aplikime edhe në raport me organizatat ndërkombëtare. Vështirësia në përgatitjen e aplikimeve dhe mungesa e informacionit ka bërë që 33 bashki të mos aplikojnë asnjëherë te këto organizata.

Pagesa që nuk aplikohet për financime nga donatorë/OJF?



IV. Përfundime

Strukturat vendore të mbrojtjes sociale

Funksionet e mbrojtjes sociale në bashki rezultojnë të strehuara në struktura me emërtime të larmishme dhe me funksione po kaq të larmishme brenda tyre, duke bërë që të kemi struktura pa identitet të qartë për kujdesin social. Përgjithësisht, bashkitë qendër qarku kanë në strukturën e tyre organizative drejtori të shërbimeve sociale, ndërsa, në rastin e bashkive të tjera, strukturat janë më së shumti modifikime të sektorëve tradicionalë, për t'u dhënë një strehë funksioneve të kujdesit social. Asnjë funksion nuk e ka ende statusin e trajtimit nga një strukturë e dedikuar në të gjitha bashkitë, por funksionet që kanë struktura të dedikuara në një numër të madh të bashkive janë mbrojtja dhe përkujdesa i fëmijëve, administrimi i pagesave me para në dorë të ndihmës ekonomike dhe mbrojtja kundër dhunës gjinore në familje. Funksionet më pak të hasura në strukturat e bashkisë janë prokurimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, ngritja e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe planifikimi strategjik i shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në të gjitha bashkitë gratë e punësuar në strukturat që lidhen me kujdesin social janë një shumicë mbizotëruese, ndërsa fusha e arsimimit të punonjësve është edhe më e shumëllojshme se emërtimet e drejtorive dhe sektorëve ku punojnë. Bashkitë e Lezhës, Tiranës, Durrësit kanë përputhur në një masë të madhe pozicionet e punës me profilin arsimor dhe me eksperiencën në fushën e shërbimeve sociale, çka është një zhvillim pozitiv, ndërsa, në të gjitha rastet e tjera, eksperiencia e punës së personelit në fushën e mbrojtjes shoqërore mbetet avantazh i rëndësishëm për ushtrimin e funksionit. Rezulton se lëvizshmëria e personelit që kryen funksionet e mbrojtjes sociale është e ulët. Mungesa e përputhshmërisë së profilit arsimor me shërbimet sociale dhe lëvizshmëria e ulët e personelit jo vetëm kërkojnë zhvillimin e trajnimeve të specializuara, por edhe një investim të dobishëm e të qëndrueshëm për strukturat vendore.

Rezultatet tregojnë se më shumë se një e treta e njësive administrative nuk ka NjVNR dhe asnjë personel për kryerjen e funksioneve të njësisë në fjalë. Duke marrë parasysh se ligji e konsideron një NjVNR të ngritur vetëm kur ajo ka në përbërje punonjës in për mbrojtjen e fëmijës, punonjës in social dhe administratorin shoqëror, numri i njësive administrative pa NjVNR mund të jetë edhe më i madh. Janë 75% e punonjësve në NjVNR që kryejnë më shumë sesa një funksion, pra i shërbejnë më shumë sesa një kategorie në nevojë. Pothuaj një e katërta e njësive janë pa administrator social, ndërsa pjesa më e madhe e të tjerave ka numër të pamjaftueshëm administratorësh. Ndryshe nga bashkitë, në Njësitë Administrative funksionet e pambuluara me personel rezultojnë dhuna në familje, e ndjekur nga mbrojtja e fëmijës, ndërsa më shumë se dy të tretat e tyre nuk kanë asnjë punonjës social. Të gjitha funksionet që nuk kryhen nga NjVNR-ja mbulohen plotësisht apo pjesërisht nga ana e bashkive dhe kjo qasje është një realitet për shumicën prej tyre. Mungesa e financimeve, e ndjekur nga kapacitetet e ulëta të personelit në NjVNR-së dhe mungesa e shërbimeve specifike që pengojnë trajtimin e rastit nga ana e tyre janë vështirësitë kryesore të NjVNR-ve.

IV.1 Burimet njerëzore dhe kapacitetet

Nga bashkitë e intervistuar, 80% u shprehën se personeli aktual nuk është i mjaftueshëm dhe pjesës më të madhe të bashkive pa personel të mjaftueshëm kanë nevojë për katër ose më shumë punonjës shtesë. Mungesa e buxhetit është arsyeja e deklaruar pothuaj nga të gjitha bashkitë për mungesën e personelit. Përfshirja e punonjësve të bashkisë në menaxhimin e rasteve që ligjërisht bëhet nga personeli i NjVNR-së është një realitet për të gjitha bashkitë. Për strukturat e shërbimit social në bashki, vështirësitë kryesore në plotësimin e funksioneve lidhen me mungesën e financimit të aktivitetit, pamjaftueshmërinë e personelit të angazhuar dhe mungesën e kapacitetit punonjësve.

Mangësitë në kapacitetet e personelit duhen trajtuar me trajnime, por më shumë se gjysma e bashkive pohojnë se nuk kanë plane për trajnimin e punonjësve dhe pjesa më e madhe e bashkive që disponojnë një plan trajnimi nuk e kanë atë individual për secilin punonjës. Deklarohet se personeli i bashkive ka marrë trajnime mbi procedurat e ngritjes së shërbimeve, prokurimin e shërbimeve, standardet kombëtare dhe teknikat e monitorimit të cilësisë së shërbimeve, përfshirjen sociale dhe aksesueshmërinë, trajnime që konsiderohen të dobishme dhe shumë të dobishme. Megjithatë, është me interes fakti se nevoja për të marrë këto trajnime është njëloj, si për personelin që është trajnuar, ashtu dhe për atë që nuk është trajnuar.

IV.2 Përshtatshmëria e mjediseve të punës

Bashkitë janë shprehur lidhur me përshtatshmërinë e mjediseve të punës për të punuar profesionalisht me menaxhimin e rasteve, veçanërisht me personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe viktimat e dhunës në familje. Sipas raportimit, vetëm një e katërta e bashkive kanë mjedise të përshtatshme dhe vetëm 8% e bashkive me mjedise të papërshtatshme shprehën se kanë planifikuar fonde për ndërhyrje në këtë drejtim.

IV.3 Koordinimi, komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Bashkëpunimi ekziston me institucionet qendrore në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, por fusha dhe masa e bashkëpunimit ndryshon. Bashkëpunimi me NjVNR është pothuaj plotësisht i lidhur me identifikimin e grupeve në nevojë për NE dhe për shërbime sociale dhe me fushatat e informimit në komunitet, çka provon që roli i NjVNR-së është ende pasiv në trajtimin e nevojave, bashkëpunimi me drejtoritë dhe strukturat në bashki është më së shumti me drejtorinë e financës lidhur me pagesat e ndihmës ekonomike dhe PAK-ut, si dhe lidhur me buxhetimin e aktiviteteve dhe të shërbimeve.

Bashkitë kanë vështirësi në aplikime edhe në raport me organizatat ndërkombëtare. Vështirësia në përgatitjen e aplikimeve dhe mungesa e informacionit ka bërë që 33 bashki të mos aplikojnë asnjëherë te këto organizata. Më pak se gjysma e bashkive kanë komunikim me MShMS-në, ndërsa vetëm 4 bashki pohojnë se kanë komunikuar për Fondin Social. Bashkitë presin që Ministria t'i mbështetë me buxhet të dedikuar për shërbimet sociale, me trajnime për ngritjen e kapaciteteve dhe për financimin e Planit Social dhe ngritjen e qendrave komunitare. Bashkëveprimi me organizatat e shoqërisë civile ndodh në lidhje me informimin, menaxhimin e rasteve, financimin e shpenzimeve për menaxhimin e rasteve dhe trajnime.

IV.4 Shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki

Mungesa e financimit dhe mungesa e burimeve njerëzore janë vështirësitë më të mëdha për zbatimin e planeve sociale sipas afateve dhe cilësisë së parashikuar për bashkitë. Procesi i hartimit të planeve sociale ka përkuar me ngritjen e strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në shumë bashki, si dhe me krijimin e NjVNR-ve në njësitë administrative. Bashkitë paraqesin një situatë mjaft të larmishme lidhur me njësitë/burimet njerëzore në dispozicion që vlerësojnë nevojat për shërbime dhe disponojnë nivele të ndryshme të ofertës së shërbimeve për t'iu përgjigjur rasteve që duhet të menaxhojnë. Nevoja më e madhe e artikulluar nga bashkitë lidhur me planet sociale vendore është mbështetja financiare për të përballuar buxhetin për shërbimet.

Aktualisht, nuk ka asnjë shërbim që të jetë i pranishëm në të gjitha bashkitë, ndërsa çdo shërbim i parashikuar nga VKM Nr. 518 ekziston në të paktën një bashki. Informimi dhe këshillimi është shërbimi më i përhapur, i ndjekur nga shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbimet e emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje dhe qendra ditore për të moshuarit. Shërbimet më të pambulluara janë strehëza për të rriturit në rrezik, për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social, shërbimet e rehabilitimit për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar, strehëza për të rriturin ose të moshuarin që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten, strehëza për gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç, strehëza për fëmijët në konflikt me ligjin, strehëza për fëmijën dhe/ose të rriturin viktimë të abuzimit apo strehimi afatgjatë për personat me aftësi të kufizuar. Vërehet gjithashtu se shërbimi i këshillimit online apo me telefon është i pranishëm vetëm në 23 bashki, ndonëse këto shërbime janë kombëtare.

IV.5 Financimi i shërbimeve sociale

Shërbimet financohen nga tri burime, konkretisht, të ardhurat vendore, fondet e pushtetit qendror dhe financimi nga OJF-të. Pësha e financimit nga pushtetit qendror është e kufizuar, por ende e rëndësishme në rastin e financimit të strehimit për personat me aftësi të kufizuar, strehimit të të moshuarve apo qendrës për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Megjithatë, për ta bërë të zbatueshëm planin social, bashkitë shpresojnë më së shumti të buxheti i shtetit si burim financimi, ndërkohë që vetëm gjysma e bashkive përdorin të ardhurat e veta dhe fondet e organizatave joqeveritare. Zbatimi i tarifave është praktikë vetëm në dy bashki. Masa e të ardhurave vendore të përdorura për të financuar shërbimet sociale mbetet në nivele minimale.

Një e treta e bashkive ballafaqohet me mungesë kapacitetesh dhe informimi për të aplikuar për mbështetje nga Fondi Social në ministri. Bashkitë përdorin burime të ndryshme për të përgatitur aplikimet për Fondin Social, që përfshijnë strukturat e bashkisë, bashkëpunimin me organizata qeveritare dhe, në raste të rralla, edhe konsulencë të jashtme. Sidoqoftë, dy të tretat e bashkive pohojnë se kanë vështirësi që vijnë si rezultat i mungesës së përvojës dhe ekspertizës për këtë qëllim. Për t'i tejkaluar vështirësitë, duket se mënyra më e preferuar për bashkitë është angazhimi i konsulentëve të jashtëm dhe marrja e trajnimeve për këtë qëllim, përfshi orientimin nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Bashkitë kanë vështirësi aplikimi edhe në raport me organizatat ndërkombëtare. Për shkak të kësaj vështirësie në përgatitjen e aplikimeve dhe mungesës së informacionit, 33 bashki nuk kanë aplikuar asnjëherë për fonde të këto organizata.